

V E N D I M
Nr.411, datë 7.8.1995

PËR ZGJERIMIN E AKTIVITETIT TË SHËRBIMIT POSTAR

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Ndërmarrja e Postave Shqiptare në veprimtarinë e saj, ka të drejtë të kryejë shërbime të karakterit financiar dhe bankar. Si agjent fiskal për shtetin dhe si agjent bankar i pajisur me licensë të dhënë nga Banka e Shqipërisë për çështjet e mëposhtme:

a) Për arkëtimin e të gjitha taksave e tatimeve të subjekteve juridike e fizike private, në qytet e fshat.

b) Për arkëtimin e xhiros nga subjektet private dhe transferimin në llogaritë likuiduese, apo depozitave të tyre pranë bankave të nivelit të dytë.

c) Për arkëtimin dhe xhirimin e të ardhurave nga zhdoganime të kolipostës për llogari të organeve doganore.

f) Për arkëtimin e detyrimeve të konsumatorëve privatë për ujë, drita, qira, abonent telefonik, aparate televizive e të tjera të këtij lloji.

e) Për arkëtimin e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga marrja e licencave të ndryshme, pasaportave, patentave, akteve noteriale, vendime gjyqësore, siguracionet e automjeteve etj.

f) Për arkëtimin e pagesave që bëjnë qytetarët për shërbimet e ndryshme që kryejnë institucionet shtetërore e shoqërore, si për Radiotelevizionin, sponsorizimet etj.

g) Për arkëtimin e abonimeve në revista, gazeta, shtypi, gazeta zyrtare, buletine periodike etj.

h)Për kryerje pagesash për pensione pleqërie, invaliditeti, të luftës, përkrahje sociale, ndihmave financiare, ndihma apo shpërblime nga aksidentet, primet e sigurimeve shoqërore etj.

i)Për kryerje të veprimeve bankare si pagesa me të holla në dorë (cash) të qytetarëve për ceqet dhe mandatet e dërguara nga post-bankat, apo administratat postare të shteteve të tjera, konvertime të valutave, transferim fondesh monetare dhe valutore brenda dhe jashtë vendit, të tregut të letrave me vlerë etj.

j)Për veprimtari të lirë biznesi në fushën e shitjes së llotarive të ndryshme, të librit artistik e shklollor, gazetave dhe revistave, kancelerive të ndryshme, kryerje shërbimi daktilografimi, fotokopjimi etj.

k)Për shitje të pullave të taksave për veprime gjyqësore, noteriale, hipotekore, të gjendjes civile etj., kundrejt përfitimit prej 5 për qind, siç është parashikuar në ligjin “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”.

Për arkëtimin e tatimeve dhe taksave nacionale dhe lokale, Ndërmarrja e Postave Shqiptare përfiton vetëm përqindjet e caktuar në ligjin e sipërpërmendur, pa opërfituar nga qytetarët tarifa të tjera shërbimi. Për të gjitha rastet e tjera Ndërmarrja e Postave Shqiptare arkëton nga klientët vetëm tarifa shërbimi.

2.Ndërmarrja e Postave Shqiptare, në zbatimin e shërbimeve si agjentë fiskalë, bankare apo dhe shërbimeve të tjera të veçanta, respekton dispozitat ligjore si dhe rregullat e evidentimit, afatet e derdhjes etj., të miratuara për çdo rast. Për këtë vepron në bazë të marrëveshjeve paraprake të lidhura me çdo subjekt përgjegjës të çdo lloj veprimtarie (shërbimi) të përmendur në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi